



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1629/4 prot.

Datë 08.07.2025

V E N D I M

Nr. 861/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 08.07.2025, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Modifikimi i dokumenteve të procedurës së prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me nr.REF-51751-06-19-2025, me objekt: “Blerje paisje kompjuterike, fotokopje dhe printera për vitin 2025”, me fond limit 3,331,809 lekë pa tvsh, parashikuar për t’u zhvilluar me datë 03.07.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kolonjë.

Ankimues: Operatori ekonomik “Optima Communication” SHPK me NUIS K71903025A dhe adresë: Rruga Shyqyri Berxolli, Pallati Inter Co-Sat, Seksioni B, Kati i 6-te, Nr. 6/5, Dera 28B, Tirane.

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Kolonjë
Sheshi “Rilindja”, Kolonjë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar; Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar; Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”; Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë

5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi

Vëren:

I

Vlerësimi Paraprak

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 20.06.2025, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me nr.REF-51751-06-19-2025, me objekt: “Blerje paisje kompjuterike, fotokopje dhe printera për vitin 2025”, me fond limit 3,331,809 lekë pa tvsh, parashikuar për t’u zhvilluar me datë 03.07.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kolonjë.

II.2. Në datën 23.06.2025 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2025/5457, protokolluar me nr. 1629/2025 prot, datë 24.06.2025, e operatorit ekonomik “Optima Communication” SHPK, me anë të së cilës kërkohet modifikimi i dokumenteve të procedurës së mësipërme të prokurimit.

Konkretisht në ankesë pretendohet si vijon:

“[...]

Ne Njoftimin e Kontrates, Seksioni 2, si edhe ne shtojcen 7 - Formulari I Sasise dhe Grafikut te Levrimet, eshte kerkuar:

2.11 Kohezgjatja e kontrates ose afati i zbatimit te kontrates:

Kohezgjatja ne muaj ??? ose dite 10 (dhjete) dite nga data e lidhjes se kontrates

Artikulli Pershkrimi Shuma Destinacioni

Periudha e dorezimit

1 Blerje paisje kompjuterike, fotokopje dhe printera per vitin 2025

Sipas preventivit bashkengjitur Magazina e Bashkise Kolonje 10 (dhjete) dite nga data e lidhjes se kontrates.

ARGUMENT 1

List ae produkteve te kesaj procedure eshte:

1 1 UPS 1000VA cope 12

2 2 KOMPJUTERA Eorkstation Advanced (Sipas Prodhuesit) cope 2

3 3 FOTOKOPJE Multifunction Color MFP Basic cope 1

4 4 KOMPJUTERA Desktop 2 cope 10

5 5 FOTOKOPJE Multifunction B&E MFP Basic cope 1

6 6 PROJEKTOR Tipi 2 cope 1

7 7 PRINTER All In One B&E cope 9

8 8 Laptop Praktik cope 1

9 9 Sëitch me 5 porta cope 2

Afati 10 ditor per levrim eshte jasht mase i shkurter per procedura te tilla, ne kete periudhe te vitit.

Ne procedura te ndryshme prokurimi te zhvilluara nga AK te ndryshme, kerkohen lloje nga me te ndryshmet te pajisjeve kompjuterike, dhe eshte e pamundur per nje OE ti mbaje gjendje ne magazine te gjitha llojet e pajisjeve, ne sasite e kerkuara. Patjeter qe OE kane nevoje te furnizohen ne momentin qe shpallen fitues te nje procedure te caktuar. Sjellim ne vemendje qe pajisjet kompjuterike nuk prodhohen ne Shqiperi, jane produkte importi, dhe afati 10 ditor eshte tejet i pamjaftueshem per te bere porosi tek furnitoret e huaj, per te importuar furnizime nga jasht shtetit, per te bere procedurat e detyrueshme te zhdoganimit, magazinimit dhe levrimet te mallit te AK.

Mendoni qe brenda ketyre 10 diteve perfshihen se 1-2 fundjava.

Nje tjeter veshtiresi e shtuar eshte fakti qe afati i levrimet perkon me muajin gusht qe sic e dime eshte muaj pushimet per furnitoret e huaj duke na e bere thuajse te pamundur levrimin.

Te tilla afate levrimi jane diskriminuese dhe pengojne konkurencen ne procedura prokurimi, duke mos lejuar ofertimin, sidomos per biznesin e vogel dhe te mesem, pengojne pjesemarrjen e OE dhe nuk jane aspak gjithepershires. Nje tender me afat kaq te shkurter dhe ne nje periudhe kaq te veshtire te vitit per te marre furnizime (per shkak te pushimeve verore), mund te realizohet vetem nga ndonje OE i paracaktuar qe e ka gjendje mallin ne magazine, duke perjashtuar nga prokurimi te gjith operatoret e tjere, te cilet mund te ofrojne edhe cmime shume te favorshme per AK, por nuk mund te ofertojne per shkak te pengeses qe vendos nje afat kaq i shkurter i zbatimit.

Sjellim ne vemendje se mallrat qe po prokurohen jane pajisje kompjuterike, pra nuk jane mallra emergjence, perkundrazi jane aktive afatgjata, prandaj nuk ka asnje arsye per afat levrimi te shkurter qe nuk lejon OE te bejne punen e tyre. Lista perbehet nga artikuj te shumellojshem, te

cilet vijne nga prodhues te ndryshem, dhe OE kane nevojë per kohen e tyre per te grumbulluar mallrat e kerkuara.

Gjithashtu ne kete rast shkelet neni 77 I Ligjit te Prokurimit Publik, I ndryshuar, pasi kerkesa nuk eshte ne perpjestim me natyren e kontrates qe po prokurohet. [...]

AK ka detyrimin te marre masa per zhvillimin ne kohe te procedurave dhe nuk ka pse OE te vuajne barren e veshtiresive te levrimet.

Ne proces-verbalin e argumentimit te kritereve nuk ka sqarime mbi afatin e levrimet.

Lutemi te mbahen parasysh veshtiresite qe na krijohen dhe te zgjatet afati ne 90 dite, per te mundesuar marrjen e furnizimeve nga jasht shtetit.”

II.3. Bazuar në nenin 112, pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.4. Në datën 27.06.2025 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr.1629/1 prot., shkresa e autoritetit kontraktor nr. 3065/1 prot., datë 25.06.2025 me objekt: “*Kthim përgjigje ankesës për procedurën e prokurimit me objekt: “Blerje pajisje kompjuterike, fotokopje dhe printera për vitin 2025”, drejtuar operatorit ekonomik ankimus “Optima Communication” SHPK, për dijeni Komisionit të Prokurimit Publik. Referuar kësaj shkrese rezulton se autoriteti kontraktor e ka refuzuar ankesën e ankimuesit, duke argumentuar si vijon: “[...] Autoriteti kontraktor Bashkia Kolonjë, [...] pasi mori në shqyrtim dhe analizoi sugjerimet e subjektit ankimues “Optima Communication” SHPK vendosi të mos pranojë dhe të mos marrë ne konsideratë ankesën e operatorit ekonomi ankimues me argumentin se kërkesa jonë që furnizimi të bëhet brenda 10 ditësh është një kërkesë e drejtë dhe ligjore, e cila nuk sjell/krijon asnjë vështirësi për realizimin e saj për subjektin ekonomik i cili mund të rezultojë fitues dhe më pas kontraktues i prokurimit në fjalë për arsyet se:*

1. Ky afat është përcaktar nga ana jonë pasi jemi të kushtëzuar nga arsye objektive menaxhimi dhe nga nevojat e ngutshme për kryerjen e këtij furnizimi, kështu që të ndodhur në këto kushte mendojmë se opertori ekonomik ofertues duhet ti marrë masat për të patur aftësinë e realizimit të objektit të prokurimit, sipas kërkesës së autoritetit kontraktor, kërkesë që mendojmë se është e drejtë dhe proporcionale me objektin e prokurimiti.

2. Vendosja e një afati furnizimi më të gjatë dhe aq më tepër për 90 ditë që kërkohet nga subjekti ankimues, do të krijonte konfuzion dhe problematika në plotësimin e nevojave të Bashkisë Kolonjë me materialet objekt prokurimi paasi janë nevoja urgjente për ecurinë e punës.”

III

Komisioni i Prokurimit Publik

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesës dhe dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe informacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton:

III.1. Për sa i përket pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues “Optima Communication” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në shtojcën 7 “Formulari i sasisë dhe grafiku i lëvrimit” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt - ankimi përcaktohet si më poshtë:

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

Afatet e lëvrimit:

Sasia e mallit që kërkohet dhe afatet e lëvrimit paraqiten në tabelën si mëposhtë:

<i>Art.</i>	<i>Përshkrimi</i>	<i>Shuma</i>	<i>Destinacioni</i>	<i>Periudha e dorëzimit</i>
<i>1</i>	<i>Blerje paisje kompjuterike, fotokopje dhe printera për vitin 2025</i>	<i>Sipas preventivit bashkëngjitur</i>	<i>Magazina e Bashkisë Kolonjë</i>	<i>10 (dhjetë) ditë nga data e lidhjes së kontratës</i>

Sipas preventivit të publikuar në SPE është parashikuar si vijon:

PREVENTIV

Objekti: Blerje paisje kompjuterike, fotokopje dhe printera për vitin 2025

Investitori : Bashkia Kolonjë.

Periudha : Viti 2025

NR	EMËRTIMI I MALLRAVE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI	VLEFTA
1	UPS 1000VA	copë	12		
2	KOMPJUTERA Workstation Advanced (Sipas Prodhuesit)	copë	2		
3	FOTOKOPJE Multifunction Color MFP Basic	copë	1		
4	KOMPJUTERA Desktop 2	copë	10		
5	FOTOKOPJE Multifunction B&W MFP Basic	copë	1		
6	PROJEKTOR Tipi 2	copë	1		
7	PRINTER All In One B&W	copë	9		
8	Laptop Praktik	copë	1		
9	Switch me 5 porta	copë	2		
	Shuma pa Tvsh				-
	Tvsh-ja				-
	Shuma me Tvsh				-

III.1.2. Në formularin e njoftimit të kontratës pika 2.11 “Kohëzgjatja e kontratës ose afati i zbatimit të kontratës” është përcaktuar:

2.11 Kohëzgjatja e kontratës ose afati i zbatimit të kontratës:

Kohëzgjatja në muaj □□□ ose ditë 10 (dhjetë) ditë nga data e lidhjes së kontratës

Ose

Fillon më □□/□□/□□□□ mbaron më □□/□□/□□□□

2.11.1. Kohëzgjatja e Marrëveshjes Kuadër:

Kohëzgjatja në muaj: _____ ose ditë: _____ (nga nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër)

Ose fillon më _____ / _____ / _____ (d/m/v)

mbaron më _____ / _____ / _____ (d/m/v)

III.1.3. Autoriteti kontraktor, në kthimin e përgjigjen e ankesës ka sqaruar se: “Ky afat është përcaktar nga ana jonë pasi jemi të kushtëzuar nga arsye objektive menaxhimi dhe nga nevojat e ngutshme për kryerjen e këtij furnizimi, kështu që të ndodhur në këto kushte mendojmë se opertori ekonomik ofertues duhet ti marrë masat për të patur aftësinë e realizimit të objektit të prokurimit, sipas kërkesës së autoritetit kontraktor, kërkesë që mendojmë se është e drejtë dhe proporcionale me objektin e prokurimiti.

Vendosja e një afati furnizimi më të gjatë dhe aq më tepër për 90 ditë që kërkohet nga subjekti ankimues, do të krijonte konfuzion dhe problematika në plotësimin e nevojave të Bashkisë Kolonjë me materialet objekt prokurimi paasi janë nevoja urgjente për ecurinë e punë.”

III.1.4. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” të ligjit nr.162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.1.5. Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr.162/2021 “Për prokurimin publik” thuhet se: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.1.6. Referuar nenit 21 “Autoriteti ose enti kontraktor” të ligjit nr.162/2021 “Për prokurimin publik”, “1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe

mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.”

III.1.7. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Bazuar në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, është në të drejtën e autoritetit kontraktor të përcaktojë kriteret për kualifikim, gjithnjë kur ato janë të nevojshme dhe të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit, bazuar në legjislacionin për prokurimin publik duke mos i tejkaluar kufijtë maksimalë të përcaktuar në këtë të fundit, në funksion të qëllimit dhe parimeve të ligjit për prokurimin publik. Autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës së prokurimit.

III.1.8. Në rastin konkret, referuar pretendimit të ankimuesit, si dhe argumenteve të autoritetit kontraktor, KPP gjykon, se autoriteti kontraktor ka përcaktuar në dokumentet e tenderit që lëvrimi i mallit do të bëhet *“10 (dhjetë) ditë nga data e lidhjes së kontratës”*. Ky afat lëvrimi nuk është i mjaftueshëm për realizimin në kohë dhe me cilësi të objektit të prokurimit, duke pasur parasysh sasinë e konsiderueshme të mallit që do të lëvrohet. Ndaj KPP gjykon, se afati i lëvrimin të mallit në rastin konkret, duhet të jetë më i gjatë në përputhje me volumin dhe përmasat e kontratës, në mënyrë që ofertuesve t'ju lihet koha e nevojshme për të siguruar në kohë mallin me karakteristikat dhe specifikimet e kërkuara në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt-ankimi. Për rrjedhojë autoriteti kontraktor duhet të bëjë modifikimin e afatit të lëvrimin të mallit në mënyrë të tillë që të nxisë pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, si dhe të sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në këto procedura, për realizimin me sukses të kontratës.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Optima Communication” SHPK qëndron pjesërisht.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 30 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 *“Për Prokurimin Publik”*, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 *“Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”*, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 *“Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 *“Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e*

Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik njëzëri,

Vendosi

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Optima Communication” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me nr.REF-51751-06-19-2025, me objekt: “Blerje paisje kompjuterike, fotokopje dhe printera për vitin 2025”, me fond limit 3,331,809 lekë pa tvsh, parashikuar për t’u zhvilluar me datë 03.07.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kolonjë.
 2. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet përkatëse në përputhje me arsyetimet dhe konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe të publikojë të gjitha ndryshimet në Sistemin Elektronik të Prokurimeve.
 3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
 4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Optima Communication” SHPK.
 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

